

## Model për një letër

Kopshti  
Rruga  
Numri i shtëpisë  
Kodi postar Vendi  
Telefon Fax

Titulli Emri Emri i prindërve  
Rruga Numri i banesës  
Kodi Postar Vendi

Data

### Subjekti: Strukturimi i fazës individuale të përshtatjes në institucion – Informacion për prindërit

Të dashur prindër,

pas disa javësh erdhi momenti. Fëmija juaj do të frekuentojë një nga institucionet tona të kujdesit ditor për fëmijë. Atje ai do të shkelë në rrugë të reja, do të përshtatet me ambiente të reja, do të familjarizohet me zakone të panjohura të rutinës së përditshme, do të njohë fëmijë të rinj dhe do të përballet me të rriturit e huaj. Për fëmijën tuaj, këto hapa janë ngjarje e rëndësishme. Ai do të jetë kurioz, i ngacmuar, i pasigurt dhe ndoshta edhe pak i frikësuar ...

Ne mënyrë që fëmija juaj të ketë një fillim të mbarë dhe të ndihet si në shtëpinë e tij në qendrën tonë ditore, ai ka nevojë për shoqërimin, orientimin dhe mbrojtjen e vazhdueshme nga ne të rriturit. Ne dëshirojmë—së bashku me ju— t'ia lehtësojmë fëmijës tuaj këtë fillim të ri.

Prandaj, koha në institucionin e kujdesit ditor fillon për të gjithë fëmijët me një të ashtuquajtur "Koha e Përshtatjes", e cila synon kalimin e fëmijëve nga familja e njohur, në një botë ende të panjohur ose/ për të lehtësuar metodat e deritanishme të qendrës së kujdesit ditor.

Derisa fëmija juaj të ambientohet me mjedisin e ri dhe të ndërtojë një marrëdhënie mirëbesimi me mësuesin ose kujdestarin e tij, është e nevojshme që në ditët e para ju ta shoqëroni dhe ta mbështesni fëmijën tuaj. Ju si nënë apo baba jepini fëmijës tuaj sigurinë që i duhet për të përqaftuar me sukses këtë ndryshim të ri.

Prandaj, si prindër keni mundësinë, që të njiheni me ne dhe me rutinën e përditshme të institucionit tonë të kujdesit ditor. Ne jemi të lumtur që të flasim me ju, në lidhje me zhvillimin e fëmijës suaj, shprehitë dhe preferencat e tij. Ky shkëmbim i përbashkët është i rëndësishëm për punën pedagogjike me fëmijën tuaj.

### Kohëzgjatja e përshtatjes

Kohëzgjatja e përshtatjes është në varësi të moshës së fëmijës dhe eksperiencave të tij me njerëzit e tjerë dhe në situata ndarjeje. Në moshën nga 0 deri 3 vjeç, kjo përshtatje zgjat të paktën tre javë, në moshën foshnjore të paktën dy javë. Megjithatë, ndonjëherë mund të lindin rrethana të paparashikuara të cilat kërkojnë një zgjatje të periudhës së përshtatjes. Gjithashtu në moshë shkolllore, faza e njohjes është shumë e rëndësishme. Ecurinë e saktë individuale të përshtatjes së fëmijës tuaj, ne do ta diskutojmë në mënyrë të detajuar me ju.

## E rëndësishme për planifikimin tuaj

Lidhur me kohëzgjatjen e përshtatjes së fëmijës tuaj në institucionin tonë të kujdesit ditor, ne ju këshillojmë, që ju të merrni kohë për veten tuaj dy deri tre javë. Gjatë kësaj periudhe, fëmija juaj ka nevojë për shoqërimin dhe mbështetjen tuaj. Jepini fëmijës tuaj sigurinë dhe mbrojtjen që i nevojiten për të përballuar këtë fillim të ri.

Nëse për arsye të rëndësishme, ju nuk mund ta merrni vetë përsipër këtë gjë, atëherë një person i besuar i juaji mundet t'i qëndrojë në krah fëmijës tuaj.

Megjithatë, ne ju këshillojmë, nëse është e mundur të shmanget ndryshimi i personit shoqërues. Për më tepër ne do t'ju luteshim që dy deri tre javët e para, ju të organizoni përditshmërinë tuaj, pasi ju do te jeni të paarritshëm për një periudhe kohe të shkurtër.

Sigurohuni që përshtatshmëria e fëmijës tuaj në qendrën e kujdesit ditor të mos përkojë me ndryshimet e tjera në familjen tuaj. Gjithashtu, ne ju lutemi që të planifikoni pushimet tuaja në atë mënyrë që fëmija juaj të mos ketë periudhe të gjatë mungese, gjatë apo fill pas fazës së përshtatjes.

"Sende" familjare nga shtëpia si lodër pellushi, libra, fotografi ose një lodër e preferuar mund të jenë shumë të dobishme për fëmijën tuaj gjatë ditëve të para në një mjedis ende të panjohur.

Ne këtë në mënyrë ato sjellin qetësi.

Ju lutemi te na informoni në lidhje me zakonet dhe ritualet e fëmijës dhe familjes tuaj.

## Dizajni organizativ

Një përshtatje e suksesshme ka nevojë për një kornizë që ne do ta zbukurojmë si në vijim:

- Ne i marrim fëmijët e "ç'orientuar". Çdo javë fëmijës i caktohet një edukator apo kujdestar.
- Gjatë periudhës së përshtatjes fëmija juaj merr pjesë në strukturën e kujdesit ditor vetëm me orë.
- Përshtatja e fëmijës suaj kryhet nga një specialist arsimor.
- Fëmija juaj do të njohë ambientin e ri në hapa të vegjël.

Me mbështetjen tuaj, ju do te ndihmoni tranzicionin e fëmijës tuaj në institucionin e kujdesit ditor. Megjithatë mund të ndodhë që larmia e përshtypjeve të reja në mjedisin e ri të bëjë që fëmija juaj, gjatë javëve të para të lodhet më shpejt se zakonisht ose fëmija juaj të shfaqë reagime të pazakonta.

Mos u shqetësoni për këtë, sepse nëpërmjet pjesëmarrjes tuaj aktive ju do të dini, cilat janë detyrat e ndryshme që po kryen fëmija juaj gjatë kësaj periudhe zhvillimi.

Ne urojme një periudhë të suksesshme përshtatje për fëmijën tuaj, me ju dhe me ne. Ne jemi të gatshëm për t'iu përgjigjur çdo pyetjeje të mëtejshme. Na kontaktoni.

Urojmë për një bashkëpunim të mirë!

Me respekt